



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.10.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (vazhdim i mbledhjes plenare datë 14.10.2020).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (vazhdim i mbledhjes plenare datë 14.10.2020).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Duke qenë se të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë të pranishëm, po fillojmë mbledhjen e parashikuar për datën 21 tetor 2020.

Siç jeni në dijeni, sot kërkohet nga ana e Këshillit marrja e vendimmarrjes për 9 çështje.

Çështja e parë ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, z. {...} për shkak të dorëheqjes”.

Çështja e tretë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e strukturës së posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të

vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në këshillin e lartë gjyqësor”.

Çështja e katërt ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën Tetor – Dhjetor 2020”.

Çështja e pestë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për krijimin e Njësive të Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit”, i përgatitur nga Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Çështja e gjashtë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë”.

Më pas kemi projektvendimin që ka të bëjë me fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për praninë në shërbimin civil gjyqësor, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor.

Më pas kemi projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për këshilltarë dhe ndihmës ligjor, viti akademik 2020-2021”.

Çështja e fundit ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 179, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Atëherë kalojmë në çështjen e parë që ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Ftojme palët.

(Hyjnë në sallën e mbledhjes magistrati, z. {...} bashkë me avokaten znj. Marçela {...}, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Periand Teta.)

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Të pranishëm nga ana e Zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë?

Artur Metani: Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe Periand Teta, Këshilltar pranë Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Naureda Llagami: Dhe nga ana e magjistratit?

{...}: {...}, asistuar nga mbrojtësja Marçela {...}.

Naureda Llagami: Atëherë, siç jeni në dijeni, KLGJ në seancën e kaluar vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore, pasi e konsideroi të nevojshme të njëjtoj me parashtrësit me shkrim të magjistratit të proceduar, si dhe për të vendosur lidhur me vijueshmërinë e mëtejshme të këtij procesi.

Atëherë, unë do ftoj kolegët nëse kanë pyetje lidhur me objektin e procedimit dhe t'i drejtojmë pyetje të dy palëve.

Zoti Muharremaj?

Erjon Muharremaj: Kisha një pyetje për zotin {...}.

Në çështjen Baccichetti kundër Francës me nr. 22584/06, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është shprehur që kërkuesi duhet të jetë gjithmonë në dijeni të një raportit të rëndësishëm për procedurat përpara tij, kur kanë të bëjnë me shkelje të pretenduara.

Nga ana tjetër, neni 115 i ligjit për Statusin parashikon që në lidhje me masat disiplinore, Këshilli duhet t'i marrë parasysh këto kritere, dhe në pikën 1, nënparagrafi /ç/ bën fjalë për të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit.

Pyetja ime për zotin {...} është: A keni qenë më parë subjekt i procedimeve disiplinore gjatë karrierës tuaj 25-vjeçare? Faleminderit!

{...}: Po, -i nderuar!

Kam qenë vetëm një herë. Nuk kam marrë masë disiplinore.

Dhe zyrtarisht rezultati ka qenë 13 me 0. Pra nuk ka pasur asnjë person të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë në kontestim të veprimtarisë time gjyqësore për atë çështje konkrete.

Erjon Muharremaj: Dhe cili ka qenë objekti i procedimit disiplinor?

{...}: Objekti i procedimit disiplinor lidhesh me veprimtarinë time gjyqësore në lëshimin e një urdhri ekzekutimi të një vendimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. T’ju sqaroj?

Erjon Muharremaj: Po, ju lutem!

{...}: Situata procedurale lidhesh me faktin që vendimi për të cilin unë lëshova urdhrin e ekzekutimit, ndonëse ishte praktikë e përgjithshme e të gjithë gjykatave të Republikës së Shqipërisë, nuk përmbante në fund shënimin që ishte i formës së prerë ose jo. Nga analiza dhe shqyrtimi përkatës, shënimi në fund të vendimit mbështetesh (në qoftë se më kujtohet mirë) në VKM-në nr. 54, e cila bazohesh në pikën 15 të ligjit “Për kthimin e kompensimit të pronave”. Kishte dy vjet që ajo pikë ishte shfuqizuar dhe normalisht mua më kërkohesh të përmbaja detyrimisht, sipas këndvështrimit të ish-Inspektoratit të KLD-së, përcaktimin ligjor që duhet të paraqitesh vendimi i mbushur për atë rubrikë, në një kohë që ajo rubrikë mbështetesh në një ligj që ishte shpallur antikushtetues. Përtej kësaj, Këshilli e vlerësoi këtë rrethanë. Përtej kësaj situata procedurale në çështje paraqitesh e këndvështrimit që (më falni një moment, që ta kujtoj), që trashëgimtarët e ish-pronarit kishin paraqitur një kërkesë administrative pranë kryetarit të Agjencisë të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, duke i kërkuar që në bazë të ligjës, të bënte revokimin e vendimit në një kohë që kjo kërkesë nuk ishte trajtuar në ky këndvështrim por ishte trajtuar si kërkesë e re dhe kryetari kishte disponuar me një tjetër vendim negativ. Trajtimi në mënyrë të hollësishme i të gjithë procedurave, pra asaj që më kërkohesh ose relatohesh si shkelje, me atë çfarë kishte ndodhur në vijim u konkludua nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, që më kishte hequr çdo lloj mundësie, ajo lloj veprimtarie e cila nuk ishte ligjore sipas ligjit, pasi nuk i përgjigjeshe kërkesës dhe

interesit të palës dhe ishte një veprim kryesisht që nuk duhet të ishte ndërmarrë, kishte sjellë për problematikë situatën problematike. Domethënë nuk mund ta perceptoja dot që mund të ishte ajo situatë. S’kisha arsye dhe natyrë ligjore për ta perceptuar.

Pra thjesht për një urdhër ekzekutimi i cili nuk ka asnjë pasojë ligjore, pasi rregullohen nga neni 609 i Kodit të Procedurës Civile dhe sipas vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë për këtë aspekt të çështjes, për sa kohë që nuk është proces që zbatohet parimi i kontradiktorialitetit. Kjo ishte i nderuar.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Thatë që vendimi është në favorin tuaj. Në rastin konkret, a konstatoi Këshilli i Lartë i Drejtësisë shkelje nga ana juaj për shkak të veprimeve që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit?

{...}: I nderuar! Ajo vendimmarrje më është komunikuar me dy muaj e gjysmë me vonesë. Momentin kur është shpallur vendimi nuk kam patur dijeninë lidhur me shkakun dhe arsyetimin. Pra kur jam njohur me përmbajtjen e vendimit kam konstatuar që atje kishte mbetur i njëjti përshkrim i shkeljes; kam konstatuar që nuk ishte argumentuar asgjë në të kundërt të parashtrimeve të mia; dhe në fund, me sa më kujtohet, vendimi mbyllet që Ministri i Drejtësisë nuk kërkoi masë disiplinore.

Normalisht unë jam gjyqtar, mund të paraqes vërejtje lidhur me përmbajtjen e atij vendimi, pasi nuk përputhet fare me situatën procedurale për çfarë u debatua para Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Është vendimmarrje, e respektoj.

Erjon Muharremaj: Jo më kot përmenda jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me dijeninë. Thatë që ju është komunikuar 2.5 muaj me vonesë.

Pyetja që kam unë: Juve jeni në dijeni të përmbajtjes së vendimit të arsyetimit që ka bërë Këshilli i Lartë i Drejtësisë në vendimmarrjen e tij?

{...}: Për momentin, meqenëse nuk isha i përgatitur për këtë përgjigje, por po përpiqem të them afërsisht për këtë rrethanë. Në kohën kur e kam lexuar kam qenë në

dijeni të përmbajtjes së plotë. Aktualisht mund të më mungojë ndonjë rrethanë por thashë, ajo që më bëri përshtypje ishte fakti që nuk ishte pasqyruar asnjë argument i kundërt i gjithë analizës që parashtrova përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Erjon Muharremaj: Pra thoni asnjë argument i kundërt me parashtrimet tuaja.

{...}: Asnjë.

Erjon Muharremaj: Asnjë. Ok!

Më lejoni t'i referohem vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë me nr. 89, datë 07.07.2014, në paragrafin 10/2, po citoj: “Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. 1908 prot., datë 27.06.2013, bazuar në nenin 34, pika 2 e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së” ka vendosur tërheqjen e vëmendjes me shkrim për gjyqtarin {...}, duke mbajtur në konsideratë në rast përsëritjeje në të ardhmen. Shkak për këtë është dhënia e vendimit nr. 2859, datë 30.11.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me palë paditëse {...}; të paditur {...}, me objekt: “Shpërblim dëmi””. Pra është vendim i vitit 2011. Rikthehem tek citimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë: “Vendim i cili është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin e datës 20.09.2012, ku ka rezultuar moszbatim formal i ligjit duke shkelur dispozitat urdhëruese procedurale dhe duke mos garantuar një proces të rregullt gjyqësor”. Ky ishte arsyetimi i vendimit të apelit, ndaj vendimit tuaj. Bëhet fjalë për vendimin tuaj të datës 30.11.2011.

Në paragrafin 12 të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, po citoj: “Këshilli vlerëson, se gjyqtari {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në veprimtarinë e tij në dhënien e vendimit nr. 41-2012 3536 (750) prot., datë 23.07.2012 (pra është një vendim tjetër gjyqësor i vitit 2012) ka shkelje të pajustificuara të dispozitave urdhëruese procedurale që kanë sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë.” - në kundërshtim nga sa ju përmendët që thatë që nuk ka patur pasoja.

I rikthehem citimit...

Deshët të thoshit diçka?

{...}: Cili është ai vendim, se nuk jam fare i qartë kujt po i referoheni?

Erjon Muharremaj: Vendimi me nr. 41-2012 3536 (750) prot., datë 23.07.2012 “Ka shkelje të pajustificuara të dispozitave urdhëruese procedurale që kanë sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë. Në gjykimin e çështjes civile 11 233 02 711 41-2012/750 prot., datë 18.07.2012 me kërkuese {...}, me objekt: “Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit” për vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish pronarëve pranë Prefekturës Korçë, me nr. 251, datë 09.11.2007 dhe në dhënien e vendimit nr. 41-2012 3536 (750) prot., datë 23.07.2012, gjyqtari duhet të ishte i vëmendshëm dhe korrekt në interpretimin e të gjithë dokumentave të cilat janë administruar në dosjen gjyqësore.”

Në paragrafin 15 të vendimit: “Këshilli nuk bën kontroll mbi vendimmarrjen, mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes, administrimit dhe vlerësimit të provave, por inspekton në lidhje me administrimin e drejtësisë dhe me shërbimet gjyqësore, duke orientuar kontrollin e tij tek veprimet flagrante procedurale që diskreditojnë figurën dhe pozitën e gjyqtarit, me pasoja të dëmshme për dhënien e drejtësisë.”

Paragrafi 16: “Këshilli, duke vlerësuar edhe pretendimet e gjyqtarit, konstaton se, veprimet e kryera prej tij përbëjnë shkelje disiplinore nga ato të parashikuara në nenin 32 të ligjit 9877, datë 18.02.2008, por jo të tilla që të çojnë në shkarkimin e tij nga detyra. Me veprimet e tij, gjyqtari {...} ka kryer shkelje të disiplinës së gjyqtarit, por shkeljet e konstatuara duhet t’i korrespondojnë një mase disiplinore në raport të drejtë me shkeljen e kryer.”

Paragrafi 17: “Këshilli arrin në përfundimin, se veprimi i gjyqtarit {...} gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij gjyqësore, janë shkelje pasi përbëjnë akte dhe sjellje që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Por, për sa më sipër, Këshilli vlerëson se duhet të rrëzohet kërkesa e Ministrit për dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, duke i kërkuar Ministrit të propozojë një masë tjetër”, -dhe vendimi ka qenë siç e relatuat juve, që nuk u vendos për shkarkimin tuaj nga detyra.

Nuk keni qenë asnjëherë në dijeni të përmbajtjes së këtij vendimi të Këshillit të Lartë të Drejtësisë?

{...}: Unë e thashë që isha në dijeni të përmbajtjes së vendimit. Më është komunikuar me shumë vonesë për mua si magjistrat. Është vendim dhe ato janë rrethana të cilat pasqyrohen në përmbajtje të vendimit. Ju si Këshill i Lartë Gjyqësor e dispononi

dosjen e plotë timen si gjyqtar. Mund të shikoni të gjithë parashtrimet, jo vetëm në mbrojtje të rastit procedimor, por edhe në lidhje me atë vërejtjen me shkrim që është paraqitur, dhe mund të njiheni edhe me përgjigjet përkatëse. E vetmja gjë që më kujtohet, që kjo është rrethanë, unë po e ekspozoj, është që pasi jam njohur me përmbajtjen e vendimit, kam kërkuar për shpjegime në mënyrë verbale lidhur me atë përmbajtje dhe të paktën disa anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (ish-KLD-së) që kam kontaktuar, më kanë thënë që nuk ka qenë kjo tema e bisedës, nuk ka qenë ky diskutimi në mbledhje sepse vendimi nuk shpallet ia arsyetuar dhe unë nuk kisha sesi ta dija këtë. Biles gjyqtari në atë kohë nuk merrte pjesë as në shpalljen e vendimit, por dilte dikush që e komunikonte tek holli se çfarë ishte vendosur (pranim apo rrëzim, apo diçka tjetër). Pra kjo ka qenë situata. Në rast se duhet ndonjë shpjegim më specifik, e thashë, ka materiale të plota në përmbajtje të dosjes time, si për vërejtjen me shkrim e cila ka kohë që konsiderohet si veprimtari joligjore e ish-KLD-së për atë lloj mase siç jepeshe, pra një material të bollshëm lidhur me kontestimin e asaj vërejtjeje me shkrim; si dhe ka material shumë të bollshëm lidhur me kontestimin e shkeljes që pretendoheshe që kisha kryer.

Brunilda Kadi: Më fal, mund të ndërhyj për diçka, për të sqaruar një moment?

Erjon Muharremaj: Po, po, unë mbarova. Nuk kam pyetje të tjera. Faleminderit për sqarimet.

Brunilda Kadi: Për çfarë viti bëhet fjalë procedimi? -2014 thatë?

{...}: Procedimi disiplinor, me sa më kujtohet është në datën...

Vendimi është i vitit 2012 dhe procedim disiplinor duhet të jetë rreth datës 7 ose 10, 7 korrik 2014. Nuk e mbaj mend mirë. Jam fare i paorientuar. Kam thjesht të memorizua këto që sapo thashë.

Brunilda Kadi: Thjesht, nisur nga fakti që unë si ish-anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga 2015 e në vijim, që nga ai moment di që çdo procesverbal regjistroheshe dhe është i aksesueshëm. Nuk e di në kohë që është zhvilluar seanca...

{...}: Nuk është.

Brunilda Kadi: Sepse nisem nga ajo çfarë deklaruar që ju është thënë që ka qenë tjetër diskutimi dhe tjetër është zbardhur dhe thjesht më duket pak jo korrekte sepse ju

duhet të kishit në dispozicion procesverbalin e diskutimeve që duhet të ketë qenë i regjistruar.

{...}: Ka qenë i regjistruar por nuk është zbardhur nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë edhe sot gjendet i pazbardhur.

Brunilda Kadi: Okej, faleminderit!

{...}: Kjo ka qenë, më falni, edhe arsyeja që të paktën mora një kontakt për të kuptuar se çfarë kishte ndodhur sepse ajo që perceptova dhe ajo që mu reklamua stononte me përmbajtjen e vendimit. Këtë kam memorizuar lidhur me këtë fakt.

Megjithatë, i nderuar, mund t'ju sqaroj edhe diçka.

Mundem të sqaroj diçka lidhur me këtë rrethanë?

Naureda Llagami: Po!

{...}: Është viti 2014. Kam qenë në pozicionin e kandidatit për pozicionin e kryetarit të gjykatës dhe në këtë kohë kanë ndodhur shumë problematika për të cilat ish-anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë të njohur lidhur me problematikat e këtij kandidimi dhe i gjithë ai proces disiplinor lidheshe vetëm me këtë arsye.

Naureda Llagami: Nga kolegët, pyetje tjetër?

Atëherë, nëse nuk kemi pyetje tjetër, unë do ftoja që palët të vazhdojnë, për të vendosur lidhur me ecurinë e shqyrtimit.

(Dalin nga salla e mbledhjes magjistrati, z. {...} bashkë me avokaten znj. Marçela {...}, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Perian Teti. Vijohet diskutimi vetëm në prezencë të anëtarëve. Pas diskutimeve nga anëtarët, rihyjnë në sallën e mbledhjes palët.)

Naureda Llagami: Atëherë, Këshilli vendosi të administrohet dosja personale e magjistratit {...} dhe nëse ju kërkoni prova shtesë dhe doni të njiheni me dosjen? Palët?

{...}: E nderuar Kryetare, në ç'këndvështrim?

Në ç'këndvështrim të njihem me dosjen?

Naureda Llagami: Nëse ke nevojë të njihesh me dosjen personale tuajën.
Përmbajtjen e dosjes personale tuajën.

{...}: Po! S'më është dhënë ndonjëherë mundësia që ta konstatoj.

Naureda Llagami: Mundësia do jetë në mënyrë të menjëhershme. Nga ana e stafit administrativ do ju vihet në dispozicion i gjithë dokumentacioni që përmban dosja juaj personale.

Keni nevojë për prova të tjera shtesë?

{...}: Përveç këtyre që janë paraqitur dhe janë administruar?

Naureda Llagami: Po! Nëse keni.

{...}: Unë jo!

Naureda Llagami: Nga ana e Inspektorit?

Artur Metani: Jo!

Naureda Llagami: Atëherë, do ta shtyjme seancën dëgjimore, duke i dhënë mundësi edhe magjistratit që të njihet me dosjen.

Do lëmë një datë?

Ilir Toska: Zonja Kryetare, kam një propozim.

Ndërsa palët do duhet të përgatisin konkluzionet përfundimtare, ju lutem konsideroni sa është koha e nevojshme për ju për t'i bërë gati këto konkluzione, me qëllim që të na i paraqisni paraprakisht, që ditën e seancës ne të mund të vijojmë më shpejt. Pra të kemi mundësi të njihemi paraprakisht me konkluzionet tuaja dhe të lëmë një seancë duke e kapërcyer këtë datë, pra që ne të njihemi.

Sa është një kohë e mjaftueshme për të dy palët që të mund të bëjnë konkluzionet gati?

Artur Metani: Unë jam gati për të shprehur mendimin dhe konkluzionin përfundimtar, në bazë të të gjithë ecurisë së dy seancave.

Ilir Toska: Sa ditë mendoni që do t'ju duhet?

{...}: Personalisht, duke qenë se kam kontestuar qëndrimin e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë dhe kam parashtruar një numër të konsiderueshëm pyetje sqaruese të cilat nuk u debatuan dhe nuk u sqaruan, në qoftë se nuk është e nevojshme kjo fazë e debatit, atëherë në këto rrethana, kërkoj që të më lihet një kohë relativisht e konsiderueshme.

Ilir Toska: Çfarë nënkuptoni me këtë?

{...}: Unë nënkuptoj, 10 ditë kohë.

Ilir Toska: Do duhet që seancën ta lëmë përtej 10 ditëve, ndërkohë që për 10 ditë, palët do duhet të depozitojnë konkluzionet e tyre, që ne të kemi mundësi të njihemi dhe të vazhdojmë seancën përfundimtare.

Artur Metani: Që ta kuptoj drejt, -do i dërgoj me shkrim konkluzionet përfundimtare paraprakisht?

Ilir Toska: Po, -duhet të na i depozitoni paraprakisht, me qëllim që ditën e seancës të përqendrohemi tek gjërat thelbësore, ndërkohë ne jemi njohur paraprakisht me të gjithë materialin tuaj.

Artur Metani: Qartë!

{...}: Jam dakord.

Edhe një gjë, ju lutem, Kryetare!

Arsyeja që duhet të njihem me dosjen, në kuptimin procedural të këtij procesi?

Ilir Toska: Nëse doni të njiheni me dosjen tuaj personale, mund ta merrni të gjithë dosjen siç është. Nëse mendoni që nuk ka vlerë për ju që të njiheni, thoni që unë s'kam nevojë të njihem.

{...}: Dakord.

Jo, -unë kam nevojë.

Artur Metani: Kam edhe një pyetje, ju lutem.

Meqenëse doli edhe çështja apo prezantimi i dosjes, ka mundësi ta shohim edhe ne dosjen?

Ilir Toska: Patjetër! Mund të njohën të dy subjektet me këtë provë që ne vendosëm ta marrim gjatë shqyrtimit. Që tani mund të merrni kopje të dy palët.

Artur Metani: Faleminderit!

{...}: Vetëm ju lutem, në qoftë se është e domosdoshme që ta paraqesim në rrethanat që thashë, me shkrim paraprakisht, për të mos u zgjatur, minimumi 10 ditë.

Ilir Toska: Po pra, të konsiderojmë seancën ta lëmë përtej 10 ditëshit.

{...}: Faleminderit!

E nderuar Kryetare, mund t'i dërgoj në rrugë elektronike parashtrimet?

Jam larg edhe...

Dakord.

Artur Metani: Kryetare, më datë 16-17 nëntor unë nuk jam në Shqipëri. Jam në një vizitë zyrtare jashtë Shqipërisë.

Naureda Llagami: Atëherë, seancën do ta lëmë me datë 5 nëntor, ora 12:00.

Atëherë, me kaq po e mbyllim seancën për sot.

{...}: Faleminderit!

(Dalin nga salla e mbledhjes magjistrati, z. {...} bashkë me avokaten znj. Marçela {...}, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Perand Teta.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.10.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, z. {...} për shkak të dorëheqjes”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Medi Bici).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, z. {...} për shkak të dorëheqjes”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Medi Bici).

Naureda Llagami: Projektvendimi në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, z. {...} për shkak të dorëheqjes, projekt-akt i cili është përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit dhe do relatohet nga z. Medi Bici.

Medi Bici: Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 pika c) të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 80, pika 3, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në

nenin 64, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” është organi kompetent për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për ndihmësit ligjor.

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 05.10.2020, është depozituar një kërkesë me shkrim (protokolluar me nr. 4866 prot.) nga ndihmësi ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, z. {...}, nëpërmjet të cilës ai ka parashtruar dorëheqjen e tij nga ushtrimi i detyrës.

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 09.10.2020 është depozituar gjithashtu shkresa nr. 19/2 prot., dërguar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër me të cilën dërgohet për kompetencë e njëjta kërkesë për dorëheqje e z. {...}.

Me Urdhër nr. 562 prot., datë 16.07.2015 të Kryetarit të Gjykatës, z. {...} është emëruar si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.

Në kërkesën e tij, z. {...} ka kërkuar: “Dorëheqjen nga ushtrimi i detyrës së Ndhmësit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër”.

Si motiv të kërkesës së tij z. {...}, ka parashtruar faktin: “Shkaku i paraqitjes së kësaj kërkesë...është për arsye familjare. Aktualisht banoj në qytetin e Përmetit së bashku me bashkëjetuesen time...Më datë 28.09.2020 u lind fëmija ynë i dytë ... Jemi para faktit se jetoj në Përmet dhe udhëtoj çdo ditë nga vendbanimi për në vendin e punës, në qytetin e Gjirokastrës. Me ardhjen në jetë të djalit të dytë, ndjej se duhet të rri më pranë familjes.”

Me shkresën nr.532 prot., datë 06.10.2020, regjistruar me aktin nr. 1912 prot., datë 09.10.2020, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër ka përcjellë për kompetencë dorëheqjen e z. {...}.

Gjithashtu nga Institucioni i Presidentit ka ardhur e njëjta kërkesë pra për dorëheqje.

Bazuar në pikën 4, Neni 179/b dhe Neni G, është subjekt i rivlerësimit ex officio dhe si i tillë gëzon të drejtën e dorëheqjes gjatë periudhës së rivlerësimit.

Neni 80, Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” parashikon: “1. Ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në ligjin “Për nëpunësin civil”, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj..... 3. Organi kompetent për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor, është

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë është Këshilli i Gjykatës ku ai ushtron funksionin”.

Përfundimisht, ne si Komision i Planifikimit Strategjik i kërkojmë Këshillit:

1. Ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, z. {...}, për shkak të dorëheqjes së tij nga detyra.

Gjithashtu, Komisioni ka përgatitur edhe projektvendimin përkatës, i cili do të lexohet pastaj nga Kryetarja.

Naureda Llagami: Keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, z. {...}, për shkak të dorëheqjes.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojmë më datë 04.11.2020.

3. Njoftimi i këtij vendimi z. {...} si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.10.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e strukturës së posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e strukturës së posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës. Në fakt bëhet fjalë për një projektvendim që ka të bëjë me caktimin e strukturës së posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në fakt, ligji për garantimin dhe integritetin e këtyre personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, ka si qëllim të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve shtetërore, institucioneve të pavarura. Gjithashtu, ky ligj ka përcaktuar ndalimin për t’u emëruar në funksion publik të gjyqtarit apo prokurorit nëse personi ka kryer një sërë veprash penale të parashikuara. Po ashtu ligji ka përcaktuar se

gjyqtarë dhe prokurorë, përpara emërimit duhet të plotësojnë formularin e vetëdeklarimit i cili administrohet pranë titullarit apo organit që bën emërimin.

Në zbatim të vendimit nr. 17/2016 i Kuvendit “Mbi rregullat e detajuara dhe afatet për plotësimin, dorëzimin, administrimin dhe publikimin e vetëdeklarimeve”, ka përcaktuar se ky formular deklarimi duhet të dorëzohet dhe administrohet nga organi përgjegjës për emërimin, transferimin dhe ngritjen në detyrë, për gjyqtarët ose prokurorët. Gjithashtu, ky vendim ka përcaktuar se secili prej organeve përgjegjëse për administrimin e formularit krijon një strukturë të posaçme ose cakton personat përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit.

Duke pasur parasysh se Ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka caktuar si strukturë përgjegjëse persona që sot nuk janë më në strukturën e Burimeve Njerëzore, atëherë lindi e nevojshme nga kjo strukturë që të bëhet ndryshimi, duke iu përshtatur strukturës aktuale që ne sot kemi një Drejtorin të Burimeve Njerëzore, për këtë arsye, projekt-akti ka propozuar që nga struktura që lidhej dhe tashmë është pjesë e buxhetit, t’i kalojë Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, i cili është autoriteti përkatës që merret me të gjithë të dhënat, jo vetëm të magjistratëve, por të këshilltarëve, ndihmësve ligjorë dhe kancelarëve.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, si strukturë e posaçme, për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit, në zbatim të nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, (i ndryshuar) dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015.

2. Formularët e vetëdeklarimit dhe i gjithë dokumentacioni i krijuar nga struktura e posaçme e caktuar me vendimet nr.39, datë 11.04.2016 dhe nr. 54, datë 25.04.2016, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i dorëzohen me procesverbal, strukturës së posaçme të caktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Shfuqizimin e vendimit nr.39, datë 11.04.2016 dhe vendimit nr.54, datë 25.04.2016, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për caktimin e personave përgjegjës nga Departamenti të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.10.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën Tetor – Dhjetor 2020”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën Tetor – Dhjetor 2020”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e katërt të rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën Tetor – Dhjetor 2020”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe do raportohet nga zoti Muharremaj.

Erjon Muharremaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor është në bashkëpunim të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës, në kuadër të formimit fillestar dhe formimit vazhdues që kjo Shkollë organizon, me qëllim rritjen profesionale të gjyqtarëve. Në këtë kuadër, Shkolla e Magjistraturës duke filluar që prej muajit prill 2019, ka koordinuar dhe ndjekur metoda sistematike e të përshtatshme për vlerësimin e nevojave për trajnim të magjistratëve. Mendimi në lidhje me përmbajtjen tematike të Programit të Formimit Vazhdues i është

kërkuar paraprakisht edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe çdo gjyqtari. Pas këtij procesi konsultimi e marrje mendimi, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës ka miratuar “Programi Tematik i Formimit Vazhdues”, për vitin akademik Tetor 2020–15 Korrik 2021, i cili i është dërguar të gjitha gjykatave në Republikën e Shqipërisë, me qëllim që çdo gjyqtar të aplikonte, në përmbushje të detyrimit ligjor për ndjekjen e trajnimit vazhdues, në përputhje me nenin 5, të Ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Bashkë me programin e trajnimit, gjyqtarëve iu është vënë në dispozicion në rrugë elektronike, formulari i aplikimit për pjesëmarrje me tre rubrika: “Tema prioritare” “Tema niveli 2” dhe “Tema niveli 3”. Formularët e plotësuar nga ana e gjyqtarëve janë dërguar pranë Shkollës së Magjistraturës nga ana e Kryetarëve të Gjykatave dhe në vijim, në mbledhjen e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës me datë 22.09.2020, është miratuar Kalendari i Aktiviteteve Trajnuese për vitin akademik 2020-2021.

Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr.812 prot, datë 06.10.2020, ka dërguar pranë KLGJ listën e aktiviteteve trajnuese të programit të trajnimit vazhdues dhe atë të gjyqtarëve aplikues, për periudhën Tetor–Dhjetor 2020, me qëllim miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve aplikues.

Lidhur me kompetencën e Këshillit për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në aktivitetet e trajnimit vazhdues, në bazë të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pjesëmarrja e gjyqtarëve në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, miratohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Konkretisht:

Referuar nenit 272 pika 1 dhe 3 të Ligjit nr. 115/2016 parashikohet se: “1. Gjyqtarët dhe prokurorët i nënshtrohen formimit vazhdues sipas rregullave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe pikës 3, ku thuhet se: “3. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, miratojnë pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnimin vazhdues, sipas programit të përcaktuar të formimit vazhdues dhe ia dërgojnë Shkollës së Magjistraturës në fillim të vitit akademik”.

Në nenin 88 shkronja “a” dhe “c” të Ligjit nr. 115/2016 parashikohet se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe kryen detyrat e mëposhtme: “a. mban lidhje me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me trajnimin vazhdues të gjyqtarëve”, dhe në pikën /c/ “c. vendos mbi kërkesat e gjyqtarëve për trajnimin vazhdues në Shkollën e Magjistraturës”.

Referuar këtyre parashikimeve ligjore, lista e pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese të magistratëve miratohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i dërgohet Shkollës së Magjistraturës. Nga rregulli i përgjithshëm bëjnë përjashtim rastet e parashikuara nga neni 271 pika 4 e Ligjit Nr. 115/2016, në të cilin parashikohet mundësia e përditësimit të programit tematik dhe listës së pjesëmarrësve nga Shkolla e Magjistraturës, e cila njofton Këshillin për ndryshimet përkatëse në programin e trajnimit vazhdues të miratuar në fillim të vitit akademik.

Në lidhje me pjesëmarrjen në aktivitetet e trajnimit vazhdues të gjyqtarëve të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, në nenin 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin” parashikohet detyrimi ligjor i magistratëve për të ndjekur programin e formimit vazhdues në përputhje me nenin 5, pika 1 dhe pika 2 shkronja /a/ ku parashikohet detyrimi për të respektuar kufijtë e angazhimit në programin e trajtimit vazhdues, përkatësisht jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më shumë se 40 ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë pesë viteve; mundësia e pjesëmarrjes në formimin vazhdues në programin e trajnimit të organizuar jo vetëm nga Shkolla e Magjistraturës por edhe institucione të tjera në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, të njohura nga KLGJ, me kushtin që aktivitetet trajnuese të vlerësohen të përshtatshme, në raport me funksionin e gjyqtarit.

Në nenin 5, pika 6, të Ligjit nr. 96/2016 parashikohet se Këshilli, ndër të tjera, bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës edhe për përcaktimin e procedurës së pajisjes me leje për ndjekjen e aktiviteteve trajnuese.

Referuar sa më sipër, në pikën e parë të projektvendimit që i paraqitet për miratim Mbledhjes Plenare, është përcaktuar miratimi i listës së gjyqtarëve për të marrë pjesë në aktivitetet e përcaktuara.

Në pikën e dytë përcaktohet detyrimi i magistratëve për të marrë pjesë në sesionet e aktivitetit trajnues sipas rregullave të përcaktuara nga organizatori i aktivitetit.

Në pikën e tretë përcaktohet detyrimi i magjistratit për të organizuar paraprakisht punën lidhur me planifikimin e seancave dhe veprimeve që kanë lidhje me gjykimin e çështjeve, me qëllim mos shtyrjen e seancave gjyqësore për shkak të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese.

Në pikën e katërt përcaktohet detyrimi i njoftimit të vendimit Shkollës së Magjistraturës dhe Gjykatave/Institucioneve ku gjyqtarët pjesëmarrës ushtrojnë detyrën e gjyqtarit apo detyra të tjera si gjyqtarë të komanduar.

Në vlerësim të Komisionit, detyrimi i gjyqtarit për të respektuar kufijtë ligjorë minimalë dhe maksimalë të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese në referim të parashikimeve të nenit 5, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 për Statusin, me qëllim që të garantohet trajnimi i përshtatshëm në nivel sasior dhe cilësor i magjistratit, buron nga ligji dhe nuk mund të jetë pjesë e vendimmarrjes së Këshillit (Mbledhjes Plenare). Gjithsesi, referuar listës së pjesëmarrësve dhe periudhës 3-mujore, është propozuar miratimi i një pjesëmarrjeje brenda kufijve të detyrimit ligjor jo më pak se 5 ditë dhe jo më shumë se 40 ditë në vit.

Lidhur me mënyrën e trajtimit financiar të magjistratit lidhur me shpenzimet e nevojshme të udhëtimit dhe akomodimit për shkak të angazhimit në aktivitetet e trajnimit vazhdues, në nenin 5, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 parashikohet se shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të magjistratëve në ndjekje të programit të formimit vazhdues mbulohen nga fondi i miratuar për këtë qëllim në Shkollën e Magjistraturës ose fonde nga burime të tjera të përcaktuara për këtë veprimtari. Për këtë qëllim, në miratimin e listës së pjesëmarrjes është mbajtur në konsideratë jo vetëm barazia në trajtimin e kërkesave të gjyqtarëve, por edhe kombinimi i prioriteteve në temat e zgjedhura me shpërndarjen gjeografike të pjesëmarrësve në trajnime.

Duke e konsideruar një akt administrativ kolektiv, ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në referim të parashikimeve të nenit 98, pika 3, të Ligjit nr.115/2016.

Sa i përket kompetencës së Mbledhjes Plenare në trajtimin e çështjes konkrete, referuar nenit 61, të Ligjit për organet e qeverisjes, Komisioni vlerëson se, ky vendim për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues, në thelb nënkupton pajisjen e gjyqtarëve me leje për ndjekjen e këtyre trajnimeve, sipas pikës 6, të nenit 5, të

Ligjit për Statusin. Pavarësisht se çështjet që lidhen me trajnimin vazhdues të gjyqtarëve nuk janë kompetencë e Mbledhjes Plenare, për sa kohë nuk ka ende një vendimmarrje të KLGJ-së në lidhje me procedurën e pajisjes me leje për ndjekjen e trajnimeve vazhduese (akt nënligjor normativ) dhe as është miratuar një rregullore e brendshme e Këshillit për çështjet për të cilat çdo Komision i Përhershëm ka kompetenca vendimmarrëse, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale vlerëson se kjo çështje duhet të shqyrtohet në Mbledhje Plenare. Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të miratojë pjesëmarrjen e gjyqtarëve në programin e formimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën Tetor 2020 – Dhjetor 2020, sipas listës së pjesëmarrësve për çdo aktivitet trajnimi bashkëlidhur këtij vendimi, pjesë përbërëse e tij.

2. Gjyqtarët e përfshirë në listën sipas pikës 1 të këtij vendimi, marrin pjesë në aktivitetet trajnuese, në përputhje me rregullat e parashikuara në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

3. Gjyqtarët duhet të marrin masa organizative për të mos penguar ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore ose asaj për të cilën janë komanduar, në ditët që do të marrin pjesë në aktivitetin trajnues.

4. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, gjykatave dhe institucioneve të tjera ku gjyqtarët, sipas listës së miratuar bashkëlidhur këtij vendimi, ushtrojnë detyra të tjera si gjyqtarë të komanduar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.10.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i Projektvendimit “Për krijimin e Njësive të Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
11. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i Projektvendimit “Për krijimin e Njësive të Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me krimin e Njësive të Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit. Edhe kjo është çështje është përgatitur dhe propozuar në Këshill nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe do raportohet nga zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Në ushtrim të kompetencave të tij, KLGJ miraton akte normative nënligjore në lidhje me rregullat e brendshme të gjykatave. Pjesë e këtyre rregullave janë edhe ato që përmbajnë norma në lidhje me strukturën e gjykatave dhe organigramën e tyre. Deri tani të gjitha gjykatat pjesë e sistemit gjyqësor, kanë funksionuar mbi bazën e strukturave që kanë patur para hyrjes në fuqi të paketës së re ligjore, me të njëjtin numër gjyqtarësh të përcaktuar nga legjislacioni i mëparshëm (Dekreti i Presidentit nr. 7818, datë 16.11.2012).

Me qëllim rritjen e efikasitetit, në ndihmë të ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore, në Ligjin 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht nenin 42 të tij, është parashikuar ngritja e Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë çdo gjykate apeli. Kjo njësi përbëhet nga ndihmës ligjorë, kategori nëpunësish gjyqësor civil, statusi i të cilëve administrohet nga KLGJ. Praktikave evropiane e kanë përmirësuar rolin e ndihmësve ligjorë bazuar në parimin e ndarjes së punës, gjë që nënkupton se ndarja e detyrave të caktuara për autoritetet gjyqësore duhet të jetë e balancuar dhe të ofrojë trajnimin dhe specializimin e duhur. Sipas këtij parimi, është e rëndësishme që i gjithë pushteti në gjykata të mos përqendrohet në një person, tek gjyqtari. Për këtë arsye, detyrat e tyre mund t'i delegohen punonjësve jogjyqtarë, veçanërisht ndihmësve të trajnuar për aspektin juridik. Kështu, përmirësimi i rolit të ndihmësve ligjorë është konsideruar si pjesë e përpjekjeve për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të performancës së gjykatës, por edhe për të siguruar garancitë e nevojshme për të drejtën e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm, sipas nenit 6 të KEDNJ-së. Për këto qëllime, është e rëndësishme marrja e këtij vendimi që ju propozohet për miratim, i cili më pas do t'i hapë rrugën edhe plotësimit të këtyre njësive me ndihmës ligjorë që aktualisht janë në sistem, por edhe me ata që sapo kanë mbaruar programin e formimit fillestar.

Njësia e Shërbimit Ligjor, duke qenë pjesë e strukturës së çdo gjykate, kërkon vendimmarrjen e Këshillit. Kjo vendimmarrje po i paraprin në rastin konkret miratimit të të gjitha rregullave standarde për strukturën e gjykatave të apelit, për shkak të urgjencës së krijuar jo vetëm nga nevoja për të emëruar të diplomuarit nga Shkolla e Magjistraturës që kanë ndjekur programin e formimit fillestar në profilin “ndihmës ligjor” si një detyrim që na buron nga ligji, por edhe nga vendimi i sapo miratuar “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor ose për ndihmës ligjor”, (bëhet fjalë për vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, i cili është botuar në fletoren zyrtare nr.181/2020 dhe aktualisht ka hyrë në fuqi). Ngritja dhe plotësimi më pas i këtyre Njësive të Shërbimit Ligjor, do të lehtësojë punën përgatitore të gjyqtarëve të apelit e rrjedhimisht do të zvogëlojë kohën e shqyrtimit të çështjeve në apel.

Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, aktualisht në sistemin gjyqësor ushtrojnë detyrën 18 ndihmës ligjorë. E vlerësoj të rëndësishme të përmend që në këtë kategori, me termin “ndihmësi ligjor në detyrë”, referuar nenit 165 të

Ligjit për Statusin, përfshihen vetëm ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, të cilët janë njëkohësisht edhe subjekte rivlerësimi kalimtar, referuar pikës 4 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Shpërndarja aktuale e ndihmësve ligjorë në gjykata është si më poshtë:

1. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë - 8 ndihmës ligjorë;
2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës – 2 ndihmës ligjorë;
3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë – 1 ndihmës ligjorë;
4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë - 1 ndihmës ligjorë;
5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër – 1 ndihmës ligjorë;
6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë - 5 ndihmës ligjorë;

Për të gjithë “ndihmësit ligjorë në detyrë”, KLGJ me vendimin nr. 424, datë 12.20.2020 ka parashikuar si më poshtë:

Ndihmësit ligjorë në detyrë në gjykatat administrative, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të Ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si më poshtë:

a) ndihmësit ligjorë në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në të njëjtën detyrë;

b) ndihmësit ligjorë në detyrë në gjykatat administrative të shkallës së parë emërohen përkohësisht në gjykatat e apelit, si rregull, në gjykatat e apelit që mbulojnë të njëjtin juridiksionin tokësor. Emërimi i përkohshëm bëhet nga Këshilli, jo më vonë se shtatë ditë nga krijimi i njësive të shërbimit ligjor në gjykatat e apelit.

Që parashikimi i mësipërm të bëhet i zbatueshëm, lind domosdoshmëria e ngritjes së Njësive të Shërbimit Ligjor, detyrim ky i parashikuar edhe nga neni 42, pika 1 e ligjit nr. 98/2016, i cili parashikon se: “Pranë gjykatave të apelit mund të funksionojë njësia e shërbimit ligjor, e përbërë nga ndihmësit ligjorë, e krijuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Numri i ndihmësve ligjorë nuk mund të jetë më i madh se gjysma e numrit të gjyqtarëve në gjykatë”.

Në bazë të numrit aktual të gjyqtarëve në gjykatat e apelit, propozohet krijimi i “Njesisë së Shërbimit Ligjor”, me organikë si më poshtë.

1. Gjykata e Apelit Tiranë - 31 gjyqtarë - Krijohet “Njësia e Shërbimit Ligjor” - 15 ndihmës ligjorë në organikë.

2. Gjykata e Apelit Durrës - 13 gjyqtarë - Krijohet “Njësia e Shërbimit Ligjor” - 6 ndihmës ligjorë.

3. Gjykata e Apelit Gjirokastrë - 6 gjyqtarë - Krijohet “Njësia e Shërbimit Ligjor” - 3 ndihmës ligjorë.

4. Gjykata e Apelit Korçë - 6 gjyqtarë - Krijohet “Njësia e Shërbimit Ligjor” - 3 ndihmës ligjorë.

5. Gjykata e Apelit Shkodër - 10 gjyqtarë - Krijohet “Njësia e Shërbimit Ligjor” - 5 ndihmës ligjorë.

6. Gjykata e Apelit Vlorë - 12 gjyqtarë - Krijohet “Njësia e Shërbimit Ligjor” - 6 ndihmës ligjorë.

7. Gjykata Administrative e Apelit - 13 gjyqtarë - Krijohet “Njësia e Shërbimit Ligjor” - 8 ndihmës ligjorë.

8. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar - 11 gjyqtarë - Krijohet “Njësia e Shërbimit Ligjor” - 5 ndihmës ligjorë.

Në lidhje me organikën e Njesisë Ligjore të Gjykatës Administrative të Apelit, propozohet që ajo të përbëhet nga 8 ndihmës ligjorë, pavarësisht se referuar numrit të gjyqtarëve të kësaj gjykate dhe dispozitës së sipërcituar, duhet të ishin 6 ndihmës ligjorë. Ky parashikim është bërë referuar detyrimeve që burojnë nga neni 165 i Ligjit për Statusin, që parashikon vazhdueshmërinë e ushtrimit të funksionit nga këta ndihmës ligjorë në detyrë deri në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, por edhe për shkak se tashmë KLGJ ka një vendimmarrje të sajën, vendimin nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor ose për ndihmës ligjor”, ku ka parashikuar se ndihmësit ligjorë në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në të njëjtën detyrë. Nga ana tjetër pritshmëritë janë gjithmonë për rritje të numrit të gjyqtarëve të kësaj gjykate, tej numrit 13, çka do të ndikojë edhe tek numri i ndihmësve ligjorë të kësaj Njësie. Gjithsesi ky parashikim për Njësinë e Shërbimit Ligjor

në Gjykatën Administrative të Apelit Administrativ, nuk ndikon në numrin e përgjithshëm të ndihmësve ligjorë, sepse referuar numrit 102 të gjyqtarëve, ai nuk i kalon 51 të punësuar në këtë funksion.

Mbi sa më lart i propozohet Këshillit të Lartë Gjyqësor shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për krijimin e Njësive të Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit”.

Duke qenë një akt normativ nënligjor është propozuar hyrja e tij në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim për projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale).

Naureda Llagami: Këshilli vendosi: 1. Krijimin e “Njesisë së Shërbimit Ligjor” si pjesë e strukturës së gjykatave të apelit, me organikë si më poshtë:

- a. Gjykata e Apelit Tiranë - 15 ndihmës ligjorë;
- b. Gjykata e Apelit Durrës - 6 ndihmës ligjorë;
- c. Gjykata e Apelit Gjirokastrë - 3 ndihmës ligjorë;
- d. Gjykata e Apelit Korçë - 3 ndihmës ligjorë;
- e. Gjykata e Apelit Shkodër - 5 ndihmës ligjorë;
- f. Gjykata e Apelit Vlorë - 6 ndihmës ligjorë;
- g. Gjykata Administrative e Apelit – 8 ndihmës ligjorë;
- h. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar - 5 ndihmës ligjorë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.10.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë”, i gatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Marçela Shehu** (anëtare)
- 11. Erjon Muharremaj** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë”, i gatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës, i cili ka të bëjë me fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë.

Siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 dhe 97, të Ligjit nr.115/2016 “ organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 55 dhe 83 të Ligjit nr. 98/2016 “ organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, “ procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit kancelar, këshilltar ose ndihmës ligjor”, ka detyrimin të fillojë procedurën e verifikimit të kancelarëve në detyrë.

Në zbatim të nenit 90, të Ligjit nr. 115/2016 “ organet e qeverisjes së drejtësisë” Këshilli i Lartë Gjyqësor “emëron kancelarin e gjykatës dhe ndihmësit ligjor si dhe merr masa disiplinore ndaj tyre”.

Nga ana tjetër, ligji për pushtetin gjyqësor ka parashikuar që Këshilli i Lartë Gjyqësor “.... verifikon plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, sipas

parashikimeve të këtij ligji, si dhe bën verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kancelarëve në detyrë.”

Lidhur me verifikimin e kandidatëve në kuadër të rekrutimit si dhe të emërimit, fshirë edhe të kancelarëve në detyrë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar rregulloren, me anë të këtij akti nënligjor, konkretisht Kreut XI, seksioni A, pika 121, parashikon që “Procedura e verifikimit të kushteve dhe kritereve formale, të pasurisë dhe figurës, kancelarët në detyrë, fillon jo më vonë se 7 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi”.

Konkretisht kjo procedurë kalon në disa faza. Faza e parë është fillimi i procedurës së verifikimit nga Këshilli. Faza e dytë ka të bëjë me veprimet procedurale paraprake dhe verifikuese, sipas rastit, të relatorit të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ose të Komisionit të përkohshëm. Faza e tretë është shqyrtimi nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit i procedurës së verifikimit të realizuar nga relatori dhe faza e katërt është shqyrtimi nga Këshilli i procedurës së verifikimit dhe projektit-aktit të verifikimit gatitur nga relatori Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ose Komisioni i përkohshëm.

Në zbatim të këtij rregullimi, kemi fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë, ku do caktohet relatori me short secilin kandidat, nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Ky Komision me vendim nr.13, datë 18.01.2019 ka në bërje të tij Kryetaren, z. Medi Bici dhe Znj. Fatmira Luli, ndërkohë ka edhe dy anëtarë zëvendësues, që bëhet fjalë për znj. Brikena Ukperaj dhe z. Erjon Muharremaj.

Në kushtet kur Kryetarja ka pengesë ligjore për të qenë relatore në procedura që kanë të bëjnë me akte individuale, atëherë nga ana e Komisionit është propozuar që të përfshihen edhe dy anëtarët zëvendësues, të cilët kanë dhënë pëlqimin e tyre, për të marrë pjesë në këto procedura.

Lidhur me listën e kancelarëve që duhet të verifikohen, rezulton të jenë 32 kancelarë të emëruar. Më specifikisht janë:

Në gjykatat e rretheve gjyqësore, juridiksion i përgjithshëm – 17 kancelarë;

Në gjykatat administrative të shkallës së parë - 6 kancelarë;

Në gjykatat e apelit juridiksion të përgjithshëm dhe administrative – 7 kancelarë;

Në gjykatat e posaçme shkalla e parë dhe apel – 2 kancelarë.

Nga ana tjetër, nga informacioni i mbledhur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezultojnë të komanduar 6 kancelarë.

Në zbatim të rregullores që kemi miratuar, konkretisht pikës 120 të vendimit, për kancelarët në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duhet t'i sillet dokumentacioni Komisionit të Posaçëm.

Ajo që kemi parashikuar në projektvendim lidhur me strukturën është që në pikën e parë parashikohet fillimi i procedurës. Në pikën e dytë të projektvendimit janë të 30 kandidaturat të kancelarëve në detyrë, dhe më pas do hidhet procedura e shortit e cila është parashikuar që do bëhet në dy vazo. Në një vazo do përfshihen të 30 kandidatët dhe në vazën tjetër do përfshihen emrat e katër relatorëve.

Duke qenë se kemi të bëjmë me 30 kancelarë në detyrë, nga ana e Komisionit është rëndë dakord që anëtarët e përhershëm do të marrin 8 kancelarë për verifikim dhe anëtarët zëvendësues do të marrin nga 7 kancelarë në detyrë.

Jemi dakord?

Të vijojmë me hedhjen e shortit?

Fillimisht hidhen me radhë shiritat e letrës me emrat e kancelarëve në detyrë:

1. z. {...}; 2. z. {...}; 3. znj. {...}; 4. z. {...}; 5. znj. {...}; 6. znj. {...}; 7. znj. {...};
8. z. {...}; 9. z. {...}; 10. znj. {...}; 11. z. {...}; 12. znj. {...}; 13. znj. {...}; 14. znj. {...};
15. z. {...}; 16. z. {...}; 17. z. {...}; 18. znj. {...}; 19. znj. {...}; 20. z. {...}; 21. znj. {...};
22. z. {...}; 23. znj. {...}; 24. znj. {...}; 25. znj. {...}; 26. znj. {...}; 27. znj. {...}; 28. znj.
{...}; 29. z. {...}; 30. znj. {...}.

Më pas futen në enën tjetër të qelqit shiritat me emrat e relatorëve:

Medi Bici, Fatmira Luli, Erjon Muharremaj, Brikena Ukperaj.

Fillimisht përzgjidhet emri i relatorit dhe më pas emrat e kancelarëve në detyrë.
Rezultatet e shortit janë si më poshtë:

Zonja Brikena Ukperaj është relatorja e parë e përzgjedhur, e cila do të jetë relatore për: z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}.

Zonja Fatmira Luli është relatorja e dytë e përzgjedhur, e cila do të jetë relatore për: znj. {...}, znj. {...}; znj. {...}, znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}, z. {...}, z. {...}.

Zoti Medi Bici është relatori i tretë i përzgjedhur, i cili do të jetë relator për: z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Zoti Erjon Muharremaj është relatori i mbetur në enë, i cili do të jetë relator për: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}.

Naureda Llagami: Jemi dakord?

Kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve formale, të pasurisë dhe figurës, për kancelarët në detyrë.

2. Caktimin e relatorit për secilin kancelar në detyrë, si më poshtë:

1. Për z. {...}, relatore znj. Brikena Ukperaj;
2. Për z. {...}, relator z. Medi Bici;
3. Për znj. {...}, relator z. Erjon Muharremaj;
4. Për z. {...}, relator z. Medi Bici;
5. Për znj. {...}, relatore Fatmira Luli;
6. Për znj. {...}, relator z. Erjon Muharremaj;

7. Për znj. {...}, relatores Fatmira Luli;
8. Për z. {...}, relatores Fatmira Luli;
9. Për z. {...}, relatores znj. Brikena Ukperaj;
10. Për znj. {...}, relator z. Erjon Muharremaj;
11. Për z. {...}, relator z. Medi Bici;
12. Për znj. {...}, relator z. Medi Bici;
13. Për znj. {...}, relatores Fatmira Luli;
14. Për znj. {...}, relatores Fatmira Luli;
15. Për z. {...}, relator z. Medi Bici;
16. Për z. {...}, relatores Fatmira Luli;
17. Për z. {...}, relatores znj. Brikena Ukperaj;
18. Për znj. {...}, relator z. Medi Bici;
19. Për znj. {...}, relator z. Erjon Muharremaj;
20. Për z. {...}, relatores znj. Brikena Ukperaj;
21. Për znj. {...}, relator z. Medi Bici;
22. Për z. {...}, relator z. Erjon Muharremaj;
23. Për znj. {...}, relatores Fatmira Luli;
24. Për znj. {...}, relator z. Medi Bici;
25. Për znj. {...}, relatores Fatmira Luli;
26. Për znj. {...}, relator z. Erjon Muharremaj;
27. Për znj. {...}, relator z. Erjon Muharremaj;
28. Për znj. {...}, relatores znj. Brikena Ukperaj;
29. Për z. {...}, relatores znj. Brikena Ukperaj;
30. Për znj. {...}, relatores znj. Brikena Ukperaj;

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kancelarëve në detyrë të përfshirë në pikën 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.10.2020)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për praninë në shërbimin civil gjyqësor, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për praninë në shërbimin civil gjyqësor, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës i cili ka të bëjë me fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për praninë në shërbimin civil gjyqësor, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor.

Bëhet fjalë për ato kandidatë ndihmës dhe këshilltarë që kanë mbaruar vitin akademik 2019-2020 të formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës.

E njëjta bazë ligjore sikurse edhe për kancelarët. Rregullorja që kemi miratuar së fundmi në zbatim të ligjit për pushtetin gjyqësor dhe ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, parashikon që duhet t’i bëjmë verifikim kandidatëve në kuadër të rekrutimit, përfshirë edhe atyre që kanë mbaruar me sukses formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

Siç shpjegova, verifikimi kalon në katër faza.

a) fillimi i procedurës së verifikimit nga Këshilli;

b) veprimet procedurale paraprake që bën relatori i Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ose të Komisionit të Përkohshëm;

c) shqyrtimi nga Komisioni përkatës;

ç) shqyrtimi nga Këshilli i procedurës së verifikimit dhe projektit-aktit të verifikimit përgatitur nga relatori dhe miratuar nga Komisioni.

Në zbatim të këtyre rregullave, rregullorja ka ngarkuar Komisionin e Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit për kryerjen e këtyre procedurave. Për të qenë më efektiv, nga ky Komision janë parashikuar që të marrin pjesë, përveç anëtarëve të Komisionit edhe dy anëtarët zëvendësues, znj. Brikena Ukperaj dhe z. Erjon Muharremaj.

Nga lista që na rezulton, kemi 12 kandidatë që janë Këshilltarë Ligjorë dhe Ndhmës Ligjorë. Ndhmës Ligjorë janë 8, dhe pjesa tjetër janë Këshilltarë Ligjorë.

Duke qenë se kemi të bëjmë me një numër 12, atëherë do ndahen në 4 anëtarët e Komisionit në mënyrë të barabartë. Kështu që kalojmë në procedurën e hedhjes së shortit.

Fillimisht hidhen me radhë shiritat e letrës me emrat e Këshilltarëve dhe Ndhmësve Ligjorë:

1. znj. {...}, 2. znj. {...}, 3. znj. {...}, 4. znj. {...}, 5. znj. {...}, 6. znj. {...}, 7. znj. {...}, 8. z. {...}, 9. z. {...}, 10. znj. {...}, 11. z. {...}, 12. znj. {...}.

Më pas futen në enën tjetër të qelqit shiritat me emrat e relatorëve:

Medi Bici, Fatmira Luli, Erjon Muharremaj, Brikena Ukperaj.

Fillimisht përzgjidhet emri i relatorit dhe më pas emrat e kancelarëve në detyrë. Rezultatet e shortit janë si më poshtë:

Zonja Brikena Ukperaj është relatorja e parë e përzgjedhur, e cila do të jetë relatore për: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Zoti Medi Bici është relatori i dytë i përzgjedhur, i cili do të jetë relator për: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Zoti Erjon Muharremaj është relatori i tretë i përzgjedhur, i cili do të jetë relator për: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Emri i relatorit të mbetur në enën e qelqit është zonja Fatmira Luli, e cila do të jetë relatore për: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Naureda Llagami: Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për pranimin në shërbimin civil gjyqësor që kanë përfunduar me sukses formimin fillestar pranë shkollës së Magjistraturës, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor, për vitin akademik 2019 - 2020.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për znj. {...}, relatore znj. Brikena Ukperaj;
2. Për znj. {...}, relatore znj. Fatmira Luli;
3. Për znj. {...}, relator z. Medi Bici;
4. Për znj. {...}, relatore znj. Brikena Ukperaj;
5. Për znj. {...}, relator z. Medi Bici;
6. Për znj. {...}, relator z. Erjon Muharremaj;
7. Për znj. {...}, relator z. Erjon Muharremaj;
8. Për z. {...}, relatore znj. Fatmira Luli;
9. Për z. {...}, relator z. Medi Bici;

10. Për znj. {...}, relator z. Erjon Muharremaj;
11. Për z. {...}, relatores znj. Brikena Ukperaj;
12. Për znj. {...}, relatores znj. Fatmira Luli;

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kandidatëve të përfshirë në pikën 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.10.2020)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për këshilltarë dhe ndihmës ligjor, viti akademik 2020-2021”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimi në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për këshilltarë dhe ndihmës ligjor, viti akademik 2020-2021”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës, që ka të bëjë me fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimi në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për këshilltarë dhe ndihmës ligjor, viti akademik 2020-2021.

E njëjta bazë ligjore aplikohet edhe për këto këshilltarë, pra verifikimi do bëhet gjatë kohës që ato do ndjekin formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës. I njëjti Komision do vazhdojë me kryerjen e procedurave, duke përfshirë edhe dy anëtarët zëvendësues.

Nga ana tjetër, nga 15 kandidatë që janë në total, 6 nga të cilët për profilin këshilltar ligjor dhe 9 në profilin ndihmës ligjor, sipas vendimit nr. 399, datë 07.10.2020 të Këshillit.

Ju bëj me dije se këshilltarja ligjore znj. Eugena Agalliu ka depozituar dorëheqjen pranë Këshillit, për këtë arsye nuk është përfshirë tek lista për verifikimin e mëtejshëm, gjithashtu edhe disa kandidatë për ndihmës ligjorë si znj. Migena Kosta, znj. Anjeza Topçiu dhe znj. Briselda Zhuzhi kanë depozituar dorëheqjen pranë Shkollës së Magjistraturës, e cila është dërguar në rrugë elektronike pranë KLGJ-së.

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Sa i përket formulimit qoftë në titull, qoftë në pikën 1 të projektvendimit, do të ishte më korrekte sikur të hiqej togfjalëshi “që kanë plotësuar kriteret e pranimit” dhe të vijonte fjalia “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në programin e formimit fillestar...”. Të hiqet “që kanë plotësuar kriteret”. Është e tepërt. E njëjta gjë edhe tek pika 1. Dhe duhen ndryshuar vendet. Fjala “për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë” është pas Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, njësoj si në titullin e projektvendimit.

Naureda Llagami: Atëherë, Komisioni pranon propozimin e bërë nga zoti Toska.

Kalojmë tani në procedurën e shortit. Do veprojmë siç vepruam edhe në shortet pararendëse.

Fillimisht hidhen me radhë shiritat e letrës me emrat e Këshilltarëve dhe Ndihmësve Ligjorë:

1. znj. {...}, 2. znj. {...}, 3. z. {...}, 4. znj. {...}, 5. znj. {...}, 6. znj. {...}, 7. znj. {...}, 8. z. {...}, 9. z. {...}, 10. znj. {...}, 11. znj. {...}, 12. z. Ilir Korbi.

Më pas futen në enën tjetër të qelqit shiritat me emrat e relatorëve:

Medi Bici, Erjon Muharremaj, Fatmira Luli, Brikena Ukperaj.

Fillimisht përzgjidhet emri i relatorit dhe më pas emrat e kancelarëve në detyrë. Rezultatet e shortit janë si më poshtë:

Zonja Brikena Ukperaj është relatorja e parë e përzgjedhur, e cila do të jetë relatore për: z. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Zoti Erjon Muharremaj është relatori i dytë i përzgjedhur, i cili do të jetë relator për: znj. {...}, z. Ilir Korbi, znj. {...}.

Zonja Fatmira Luli është relatorja e tretë e përzgjedhur, e cila do të jetë relatore për: z. {...}, znj. {...} (Hotaj), znj. {...}.

Emri i relatorit të mbetur në enën e qelqit është zoti Medi Bici, i cili do të jetë relator për: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Naureda Llagami: Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që ndjekin programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për znj. {...}, relatore znj. Brikena Ukperaj;

2. Për znj. {...}, relator z. Medi Bici;

3. Për z. {...}, relatore znj. Fatmira Luli;

4. Për znj. {...}, relator z. Medi Bici;

5. Për znj. {...}, relatore znj. Brikena Ukperaj;

6. Për znj. {...}, relatore znj. Fatmira Luli;

7. Për znj. {...}, relator z. Erjon Muharremaj;
8. Për z. {...}, relatores znj. Brikena Ukperaj;
9. Për z. {...}, relator z. Medi Bici;
10. Për znj. {...}, relator z. Erjon Muharremaj;
11. Për znj. {...}, relatores znj. Fatmira Luli;
12. Për z. Ilir Korbi, relator z. Erjon Muharremaj.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kandidatëve të përfshirë në pikën 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Këshillin e Lartë Gjyqësor